



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. DM/A-2462/2022

Datë: 26.10.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe në nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 26.10.2022 pas diskutimit lidhur me pikën e 5 të rendit të ditës: Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit nr. 01nr 011/01-13700 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “ Tregu në Orize”, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës 01nr -011/01-13700 të datës 26.05.2022

1. Shfuqizohet Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale “Tregu në Orize” i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01nr 011/01-13700 i datës 26.05.2022 .
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .
3. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Shërbime Publike
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Arbëneshha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës